Kronikë

# Krujë, shisnin drogë pranë shkollave, në pranga 2 vëllezër binjakë, iu gjenden edhe armë

*Dy vëllezër binjakë janë vënë në pranga të policisë së Krujës, pasi shpërndanin lëndë narkotike në afërsi të shkollave. Ndërsa në banesë iu sekuestrua 1 armë zjarri automatik, 1 armë zjarri pushkë, 2 krehra automaktiku, municion luftarak dhe 1 bajonetë;*




Redaksia
23 Shkurt, 13:29 | **Përditesimi: 23 Shkurt, 13:41**

Dy vëllezër binjakë janë vënë në pranga të policisë së Krujës, pasi shpërndanin lëndë narkotike në afërsi të shkollave. Ndërsa në banesë iu sekuestrua 1 armë zjarri automatik, 1 armë zjarri pushkë, 2 krehra automaktiku, municion luftarak dhe 1 bajonetë. Në pranga kanë rënë Elson e Ervin Lita.

> *'Krujë/Sekuestrohen drogë, armë dhe municion luftarak. Finalizohet operacioni policor i koduar "Tëins", nga Komisariati i Policisë Krujë, me mbështetjen e forcave operacionale dhe të Seksionit për Hetimin e Narkotikëve, të DVP Durrës.*



LEXO EDHE:
**Merrnin 5-100 € për të lejuar kalimin në kufi të të shpallurve në kërkim, lihen në burg 6 efektivët në Durrës**

> *Prodhonin dhe shpërndanin kanabis në afërsi të shkollave dhe të lokaleve, mbanin armë zjarri dhe municion luftarak, vihen në pranga 2 vëllezër.*
>
> *Shërbimet e Komisariatit të Policisë Krujë, në vijim të punës për evidentimin dhe goditjen e paligjshmërisë, bazuar në informacionet e siguruara përmes inteligjencës policore, për 2 vëllezër që ushtronin veprimtarinë kriminale të shpërndarjes së lëndëve narkotike në doza dhe mbanin armë zjarri, në bashkëpunim me forcat operacionale të DVP Durrës dhe Seksionin për Hetimin e Narkotikëve, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Tëins".*
>
> *Si rezultat i këtij operacioni u arrestuan në flagrancë shtetasit E. L. dhe E. L., 20 vjeç (binjakë), banues në Derven, Krujë.*
>
> *Gjatë operacionit, shërbimet e Policisë, si rezultat i kontrollit në banesën e këtyre shtetasve, kanë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale:*
>
> *1 armë zjarri automatik, 1 armë zjarri pushkë, 2 krehra automaktiku, municion luftarak dhe 1 bajonetë;*
>
> *600 gramë kanabis dhe 29 doza kanabisi të përgatitura me qese farmaceutike, gati për shitje.*
>
> *Nga veprimet hetimore dyshohet se dy vëllezërit shpërndanin lëndë narkotike në doza, në afërsi të shkollave dhe të lokaleve, në Fushë Krujë dhe Krujë.*
>
> *Vijon puna për dokumentimin e plotë të veprimtarisë kriminale të këtyre shtetasve.*
>
> *Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Krujë, për veprat penale "Mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit" dhe "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", të kryera në bashkëpunim.'- njofton policia.*

Në përditësim...

M.Q./KT/Shqiptarja.com

TAG: Durres

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**Ilir Meta në SPAK, mendoni se do të zbardhet e plotë afera CEZ-DIA?**

Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera



Puseta kthehet në problem për banorët e bizneset e Durrësit, ujërat e zeza dalin në rrugë e trotuare

Aldo Mustafa
23 Shkurt, 13:00



Nga vendosja e shamisë tek puna online, historia e besimtares që kapërceu 'kufijtë' e fshatit Kullë në Durrës
22 Shkurt, 21:03



I shpallur në kërkim për shitje kanabisi, arrestohet 25-vjeçari në Krujë! Gjykata i kishte caktuar masën 'arrest me burg'
22 Shkurt, 11:32




PD e Berishës: Bashkia e Durrësit ndan fondet për rindërtimin në prag të zgjedhjeve, po manipulojnë votat
21 Shkurt, 15:55



Durrës, nuk deklaruan mbi 125 mijë euro në kufi, arrestohen 2 drejtuesit e autobusit Bari-Durrës-Bari
21 Shkurt, 15:25



Merrnin 5-100 € për të lejuar kalimin në kufi të të shpallurve në kërkim, në pranga 6 efektivë të Portit të Durrësit! 20 persona në detyrim paraqitje (EMRAT)
21 Shkurt, 11:41



Tentoi të kalonte kufirin me dokumente të falsifikuara, në pranga 36 vjeçari dhe falsifikatori në Portin e Durrësit
21 Shkurt, 11:29



Aksident në rrugën Fushë Krujë-Laç, përplasen dy makina! Plagosen dy pasagjeret, njëra prej tyre e mitur
21 Shkurt, 08:20




Aksident në Durrës, makina përplas 50 vjeçarin dhe një vajzë të mitur
20 Shkurt, 21:00




I kërkoi borxhi, 44-vjeçari tenton të vrasë me shkop bejsbolli punonjësin e karburantit në Durrës
20 Shkurt, 10:17



FOTO/ Bllokohet në Durrës anija me 22.500 tonë naftë kontrabandë nga Rusia! U porosit nga kompania 'IB Gaz' në Elbasan! Ndalohen 22 anëtarë të ekuipazhit
20 Shkurt, 09:15



Zyrtarizoi partinë e re, Evi Kokalari nis lëvizjen 'Konservatore' nga Durrësi, më 4 mars i fton qytetarët në takim
19 Shkurt, 16:48

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton



© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje